



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 06.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës: **27.10.2022** të parashtruar nga, **RSM COMPANY SHPK**, të datës 27.10.2022 të parashtruar nga "LINDI MARKINGS" Shpk dhe të datës 01.11.2022 të parashtruar nga "TSR" Shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV**", me Nr. të Prok: **616-22-11147-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 170 211** nxjerr:

V E N D I M

Aprovohen si pjeserishte e bazuara kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorve Ekonomik, **RSM COMPANY SHPK** të dt. 27.10.2022, "LINDI MARKINGS" Shpk të datës 27.10.2022 dhe "TSR" Shpk të datës 01.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV**", me Nr. të Prok: **616-22-11147-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 170 211**, kundër *Njoftimit për kontratë* të AK –së, të datës 14.10.2022.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te beje korigjimet e nevojshme si ne specifikimin teknik ashtu edhe ne kriteret e perzgjedhjes per aktivitetin e prokurimit per* "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV**", me Nr. të Prok: **616-22-611147-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 170, 211**.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

RSM COMPANY SHPK, "LINDI MARKINGS" Shpk dhe me datë 27.10.2022 dhe "TSR" Shpk me datës 01.11.2022 kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot IV**" me Nr. të Prok: **616-22-11147-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 170 211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 04.10.2022, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë.

- Pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik "**RSM COMPANY**" SHPK, "LINDI MARKINGS" dhe "TSR" Shpk janë pjeserishte të qendrueshme andaj AK duke u mbështetur në

Parimet e përgjithshme të LPP, përkatësisht në nenin 7 Barazia në trajtim / jo diskriminim që thotë se AK do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë jo diskriminuese dhe në mënyrë transparente do të bëjë korigjimin e specifikimeve teknike si dhe kërkesave të perzgjedhjes.

Po ashtu AK ka respektuar LPP dhe RRUOPP ku ka bërë vazhdimin e afatit të dorëzimit të ofertave i cili afat do të jetë i mjaftueshëm për të gjithë operatorët Ekonomik për korigjimin dhe përgaditjen e Dosjes së tenderit për në afatin e parapare.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Prishtina: datë, 15.09.2022

Nexhmi Mekolli


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit